



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 366/2016**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23/05/2016 shqyrtoi ankesën me: \_\_\_\_\_

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-25332-02-23-2016 me objekt “Shërbimi i Lavenderisë dhe Hotelerisë” me fond limit 94,813,099.16 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 21.03.2016 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli, Elbasan.

**Ankimues:**

BO “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a.  
Adresa: Rr “Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga “Lord Bajron”, Spitali Amerikan”, Kati I, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli, Elbasan  
Elbasan

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.02.2016 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-25332-02-23-2016 me objekt “*Shërbimi i Lavenderisë dhe Hotelerisë*” me fond limit 94,813,099.16 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 21.03.2016 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli, Elbasan

II.2 . Në datën 21.03.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative rezulton se në datën 31.03.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë

të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- |  |                 |              |
|--|-----------------|--------------|
| i. “BO “Sanitary Cleaning” & “Pastrimi Detar | 43,260,348 lekë | skualifikuar |
| ii. “Devis” sh.p.k.                          | 93,631,985 lekë | kualifikuar  |

II.3.1. Bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se : “[...]”

1. Nuk keni paraqitur prokurë të posacme si bashkim operatorësh ekonomikë
2. si dhe operatori ekonomik “Pastrimi Detar” sha nuk ka paraqitur Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore duke mos plotësuar Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit të kërkuara në DST.
3. Nuk keni paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë sipas kerkesave te kerkuara ne DST,
4. Nuk keni paraqitur certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te kualitetit te shoqerise ISO 9001: 2008,
5. Nuk keni paraqitur certifikatë që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2004,
6. operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001: 2004,
7. Vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për operatorin ekonomik “Pastrimi Detar” sha nuk është për të gjithë periudhën e kërkuar, ndërsa operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore,
8. Nuk keni paraqitur certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka për disponimin e një apo disa llogari bankare, me gjendje prej 10 % e fondit limit,
9. Nuk keni paraqitur dokument për të vërtetuar se keni realizuar shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit
10. Keni paraqitur dokumentacion të paplotë dhe të parregullt për ambientin ku ushtroni veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë,
11. Nuk keni paraqitur Policë Sigurimi e Përgjegjesise Profesionale për kontrata dhe eksperiencia të ngjashme me objektin e prokurimit,
12. Keni paraqitur dokumentacion të paplotë dhe të parregullt për makineritë që dispononi, operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion që të vertetojë se disponon të paktën nje mjet transporti të pershtatshem për transportin e materialeve të buta,
13. Operatori ekonomik “Pastrimi Detar” sha nuk ka konfirmuar specifikimet teknike, duke mos plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara në DST. [...]

II.4. Në datën 04.04.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: "[...] Në datën 31.03.2016, në llogarinë elektronike të shoqërisë "SANITARY CLEANING shpk" përfaqësuese e bashkimit të operatorëve ekonomik, ka ardhur mesazhi për klasifikimin e ofertueseve, ku janë skualifikuar të gjithë ofertuesit me përjashtim të shoqërisë "DEVIS" shpk, oferta e të cilit është plotë 50 371 637 lekë më e lartë se oferta jonë. Gjithashtu ka ardhur edhe mesazhi për refuzimin e ofertës së shoqërisë "SANITARY CLEANING" shpk, ku sipas të cilit, arsyet e skualifikimit nga KVO.1.Konstatimeve të mësipërme të konkuduara nga KVO nuk qëndrojnë dhe janë të pasakta, për arsyet e mëposhtme: 1. Sa i përket prokurës së posacme , shprehemi se në Nenin 3, pika 8 dhe 13 të Marrëveshjes së Bashkepunimit të Përkohshëm, është përcaktuar shprehimisht se përfaqesuesi i bashkimit të operatoreve në këtë procedure prokurimi do të jetë shoqëria "Sanitary Cleaning" shpk. Një përcaktim i tillë përbën atë që quhet "Prokure e Posacme", pasi shoqëria "Sanitary Cleaning" shpk është autorizuar nga shoqëria bashkëpunuese për ta përfaqësuar këtë bashkëpunim posacërisht për këtë procedure prokurimi dhe jo për ndonjë procedure apo lloj tjetër përfaqësimi. Prokurë e posacme nuk do të thotë një fletë apo një dokument i veçantë nga dokumenti i marrëveshjes së bashkepunimi, por ajo çka delegohet nga i përfaqësuar tek përfaqësuesi. Sa i përket mosparaqitjes së Deklaratës mbi Gjendjen Gjyqësore nga OE "Pastrimi Detar" sha, shprehemi se kjo kërkesë nga ana e AK është në tejkalim të përcaktimeve ligjore të përcaktuara nga neni 45 i LPP dhe neni 15 i RrPP. Kjo pasi në nenin 45 te LPP është përcaktuar se kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve nga nje procedure prokurimi mund të vertetohen nqpermjet:

a) një vërtetimi nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çeshtjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat "a", "b" e "c";

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çeshtjet e përmendura në pikën 2 shkronjat "d" e "dh".

Ndërsa vetedeklarimi (Deklarate mbi Gjendjen Gjyqësore) ju kërkohet të paraqitet vetëm Kandidateve apo ofertuesit e huaj, parashikuar kjo në nenin 15 te RrPP .

Neni 15 i RrPP, parashikon: "Kriteret e përgjithshme të kualifikimitlpjesëmarrjes përmbajne listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidateve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 45 te LPP. Kandidatët apo ofertuesit e huaj, shtetet e të cilëve nuk lëshojne dokumente të tilla, janë të detyruar të paraqesin për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pjesëmarrjes, një vetedeklarate me shkrim. "

2. Në lidhje me vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë, janë dorëzuar dy dokumente, përkatesisht Dokumenti i printuar dhe konfirmuar nga OSHEE i datës 15.06.2016, ku vërtetohet shlyerja e detyrimeve deri në muajin Janar (i përfshirë), si dhe dokumenti i bankës i datës 20.03.2016, ku vërtetohet shlyerjen në datën 15.03.2016 të energjisë së maturuar të muajit Shkurt në vlerën 108 943.15 leke, vlerë e cila korespondon me vlerën e përcaktuar në dokumentin e parë. Sa i përket shoqërisë "Sanitary Cleaning" shpk, sqarohet se kjo kompani e ushtron aktivitetin e saj brenda ambjentëve të Spitalit Amerikan 1 dhe 2 Tirane, në ambjentet e tregut Agro-Ushqimor Kashar Tirane, si dhe në Godinen Bushi System Rogozhinë, dhe detyrimet e energjisë elektrike shlyhen sipas marrëveshjeve përkatese, nga operatorët e mësipër privat, shërbimi i pastrimit të cilëve ju ofrohet.

3. Sa i përket xhiros mesatare vjetore, është kërkuar xhiroja mesatare vjetore e tre viteve të fundit financiare (2013, 2014, 2015) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Është dorëzuar xhiroja e viteve 2012, 2013, 2014, por gabimisht (gabim njerezor), nga ana e organeve tatimore nuk është përfshirë xhiroja e vitit 2015, por kjo nuk do të thotë se për vitin 2015 nuk ka kryer aktivitet. Për më tepër xhiroja vjetore për vitin 2015 vërtetohet nëpërmjet dokumentit të dorëzuar "Libri i shitjeve 15 Pastrimi Detar" të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durres, ku nëpërmjet të cilit vërtetohet se vetëm libri i shitjeve për vitin 2015 ka një vlerë jo 40% e fondit limit, por mbi 100% (96 244 949.83 leke). Ndërsa për sa i përket xhiros vjetore të "Sanitary Cleaning" shpk, nuk është e nevojshme dhe e detyrueshme pasi vlerën e kërkuar nga AK (40%) e plotëson dhe e tejkalon shoqëria tjetër. Përderisa në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, kriteret ekonomike, financiare dhe teknike duhet të plotësohen nga të gjithë operatorët të marrë se bashku, dhe nga ana jonë është vërtetuar xhiroja vjetore e katër viteve të fundit është jo 40%, por dyfishi i vlerës së kërkuar, atëherë AK nuk mund të deklarojë si kriter të pa përmbushur.

4. Sa i përket certifikates të gjendjes financiare, KVO nuk e ka marrë në konsiderat dokumentin e lëshuar nga BKT, dokument në të cilën vërtetohen trasaksionet bankare në llogarinë e "Sanitary Cleaning" shpk, për periudhën 01.01.2016 deri në datën 21.03.2016, ku në datën 21.03.2016, ku vërtetohet se balanca e llogarisë së "Sanitary Cleaning" shpk ka qenë jo 9 481 310 lekë që është kërkuar, por 10 970 461.72 leke, pra mbi 10%.

5. Sa i përket shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit, për të cilat KVO shprehet se nuk është paraqitur dokument për të vërtetuar se janë realizuar gjatë tre viteve të fundit, sqarohet se KVO nuk e ka patur parasysh se çfarë dokumentacioni është kërkuar nga AK për plotësimin e këtij kriteri, pasi në DST është kërkuar: "Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej 40% e fondit limit të vënë në dispozicion për secilin vit. Këto shërbime do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, OSE Kur shërbimi i i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatese tatimore të shitjes ku shënohen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." Nga ana e BOE është plotësuar pikërisht kushti i dytë, pasi vlera totale e faturave

tatiomre të shitjes kap vlerën 40 741 163 lekë për shërbimin e pastrimit nga shoqëria "Sanitary Cleaning" shpk dhe mbi 160 000 Euro (22 400 000 leke) nga shoqëria "Pastrimi Detar" shpk. 6.

Sa i përket ambjentëve ku ushtrohet aktiviteti, KVO ka vendosur që "dokumentacioni i paraqitur është i paplotë dhe i parregullt".

Për plotësimin e këtij kriteri është kërkuar që lavanretia të ketë një sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> dhe dokumentacioni përkatës, që janë: dokumentacioni përkatës i pronësisë apo në rastin e marrjes me qira e vërtetuar me kontratë hua-marrje, leje nga QKL, akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit, të jetë brenda territorit shqiptar dhe Policë Sigurimi e Përgjegjësive Profesionale për kontrata dhe eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit). Për plotësimin e këtij kriteri është paraqitur certifikata e pronësisë për sipërfaqen e objektit të ushtrimit të veprimtarisë me sipërfaqe 560 m<sup>2</sup> brenda territorit të RSH, si dhe dokumentacioni ligjor i bazuar në ligjin për legalizimet e objekteve informale, për sipërfaqen totale 1700 m<sup>2</sup>. Janë paraqitur gjithashtu leja përkatëse nga QKL dhe akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit. Sa i përket dokumentit të kërkuar "Policë Sigurimi e Përgjegjësive Profesionale për kontrata dhe eksperiencë të ngjashme me objektin e prokurimit", theksojmë që ky dokument nuk ka lidhje me objektin e lavanterisë, si dhe kjo kërkesë është në tejkalim të përcaktimeve ligjore dhe në kundërshtim me kriterin për eksperiencë të ngjashme, pasi për shërbime të ngjashme me operator privat nuk kërkohet kontratë shërbimi, por vetëm fatura tatimore, ndërsa për ambjentin e shërbimit kërkohet Policë Sigurimi e Përgjegjësive Profesionale për kontrata dhe eksperiencë të ngjashme, që është nënshprehur. 7.

KVO për ka konkluduar se është paraqitur dokumentacioni i paplotë dhe të parregullt për makineritë që disponohen. Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive është kërkuar të paraqiten fatura blerje dhe/ose zhdoganimi të shoqëruar me foto. Nga ana e BOE për përmbushjen e këtij kriteri janë paraqitur: faturat e zhdoganimit, inventari i lavanterisë, gjendja në magazinë e makinerive dhe pajisjeve rezerve në magazinë si dhe fotot përkatëse. Edhe pse në DST ishte parashikuar që makineritë e mësipërme duhet të jenë të instaluar në ambjentet e lavanterisë të cilat do të verifikohen nga KVO-ja pas hapjes së ofertave. Procedurë e cila nuk është kryer nga KVO, por apriori është vendosur që dokumentacioni nuk është i rregullt dhe nuk është kryer verifikimi në vend i pajisjeve të instaluar. 8. Sa i përket mjetit të transportit, KVO ka vendosur që ky kriter nuk është plotësuar nga operatori ekonomik "Sanitary Cleaning" shpk, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë se disponon të paktën një mjet transporti të përshtatshëm për transportin e materialeve të buta përshtatshëm për transportin e materialeve të buta. Për plotësimin e këtij kushti është paraqitur dokumentacioni përkatës i mjetit me DR8472E me kapacitet mbi 2.2 Ton, me certifikatë pronësie, kolaudim dhe siguracion mjeti. Në DST është përcaktuar që "Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një mjet transporti të përshtatshëm për transportin e materialeve të buta..., dhe nuk është theksuar që në rastin e bashkimit të shoqërive, ky kusht duhet të përmbushet nga secili pjesëmarrës në bashkëpunim.

9. Gjithashtu KVO në mënyrë absurde ka vendosur që "Operatori ekonomik "Pastrimi Detar" sha nuk ka konfirmuar specifikimet teknike ". Së pari, kjo kërkesë nuk është e logjikshme dhe e nevojshme, pasi konfirmimi i specifikimeve teknike jepet nëpërmjet Shtojcës 5 të Deklaratës

*mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të DST e cila është nënshkruar nga përfaqësuesi i BOE, dhe së dyti, shoqëria "Pastrimi Detar" sha, ka autorizuar shoqërinë kryesuese "Sanitary Cleaning" shpk, të marrë përsiper e të ushtrorë në emër të shoqërisë së përbashkët, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kërkesat e dokumentave të tenderit. Vendimi për skualifikimin e BOE është diskriminues dhe i padrejtë, pasi KVO ka synuar të bëjë skualifikim e bashkimit të operatorëve ekonomik të përfaqësuar nga "Sanitary Cleaning shpk" dhe të kualifikoje operatorin e paracaktuar, oferta e të cilit ishte mbi 2 herë më e lartë se oferta jonë. Shpallja fitues e një operatori ekonomik, oferta e të cilit për të njëjtit shërbim është mbi 2 herë më e lartë, si dhe kostoja ekstra e pajustificueshme, do të shkaktonte tatimpagueveve shqiptar një dëm ekonomik [...]"*

II.6. Në datën 11.4.2016 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.620 prot datë 11.04.2016 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.

II.6.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: "[...]Autoriteti kontraktor mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara në ankesën tuaj lidhur me vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për klasifikimin e ofertave. Nga titullari i autoritetit kontraktor në zbatim të kërkesave të ligjit për prokurimin publik u bë pezullimi i procedurave të prokurimit për tenderin konkret, si dhe u caktua punonjësi që do të bënte vlerësimin e pretendimeve të ankesës dhe dokumentacionit përkatës. Pas vlerësimit të bere, në lidhje me pretendimet e trajtuara në ankese, Ju përgjigjemi si më poshtë: I- Përsa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 1/a. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatoam se nuk ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti prokurë e posaçme si bashkim operatorësh ekonomike .Gjithashtu një detyrim i tillë jo vetëm që është i përcaktuar në kërkesat për kualifikim në DST, por dhe në nenin 74 pika 2 e VKM nr. 914 date 29.01.2014, ku përcaktohet shprehimisht se: "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës i shërbimit I furnizimit dhe elementet konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomike, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen sëbashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ".Përsa me lart pretendimi juaj lidhur me kete pike nuk qëndron. II- Përsa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 1/b. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së , konstatoam se nuk ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqiësore për operatorin ekonomik "Pastrimi Detar" sh.a.Në DST e hartuar dhe miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik përcaktohet:Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:1. Një dokument qe verteton se (subjekti juaj):a) nuk është në proces falimentimi , (statusi aktiv);b)nuk është dënuar për shkelje penale , në përputhje me Nenin 45/I te LPP,c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë , që lidhet me aktivitetin e profesional,kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit

Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 "Deklarate mbi Gjendjen Gjyqësore. Përsa më lart sqarohet se kërkesat e përgjithshme për Kualifikim janë pjesë e DST të miratuara me vendim të APP. Autoriteti kontraktor në rastin konkret nuk ka vendosur kërkesa të tilla, por thjesht ka respektuar vendosjen e tyre sipas përcaktimit të DST. Pra në rastin konkret nuk ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në kërkesat e përgjithshme përcaktohet gjithashtu: Ne rastet e bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur. Mungesa e një dokumentacioni të tillë e bën kërkesën për kualifikim të pa plotë e për këtë rast skualifikimi juaj është i drejtë. III- Përsa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 2. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatojmë se nuk ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë sipas kërkesave të kërkuara në DST". Në DST e hartuar dhe miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik përcaktohet: d. Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve nuk konstatohet asnjë vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë sipas formatit të përcaktuar në VKM 379 datë 11.06.2014. Po kështu që një dokumentacion i tillë të jetë i vlefshëm ai duhet të paraqitet prej secilit operator pjesëmarrës dhe të jetë në përputhje me përcaktimet e nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjare", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë e detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatë vonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. " Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatojmë se ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti- Vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për operatorin ekonomik "Pastrimi Detar" sha, por që nuk është për të gjithë periudhën e kërkuar, ndërsa mungon vërtetimi për xhiron për operatorin ekonomik "Sanitary Cleaning" shpk. Në DST përcaktohet :a) Vërtetimi të lëshuar nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për secilin prej 3 (tre) viteve të fundit financiare (2013, 2014, 2015) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 neni 74, pika 3 përcaktohet shprehimisht se : "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë , shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje ". Përsa më sipër jemi në kushtet e mosplotesimit të kërkesave të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 , pasi operatori ekonomik "Sanitary Cleaning" shpk nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros në % e përcaktuar në aktmarrëveshje, si dhe operatori ekonomik "Pastrimi Detar" sha nuk ka paraqitur vërtetimi xhiroje siç është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DST dhe pranuar nga operatorët



pjesëmarrës në tender. V- Përsa i perket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 4. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-se, konstatoam se nuk ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti- çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka për disponimin e një apo disa llogari bankare, me gjendje prej 10 % e fondit limit" nga asnjë prej subjekteve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në DST përcaktohet: b) Një çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka për disponimin e një apo disa llogari bankare, me gjendje (teprice) prej 10% e fondit limit, dokument i lëshuar brenda 10 ditëve nga data e hapjes së ofertave. Pas verifikimit të dokumentacionit në sistem konstaton paraqitjen e një dokumenti me emërtimin Statement Of Account i cili jo vetëm që nuk është një çertifikatë e gjendjes financiare por nuk është as në gjuhën shqipe. Detyrim ky i përcaktuar në DST. VI- Përsa i perket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 5. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatoam se ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "dokumenti-faturat përkatëse tatimore të shitjes ku shënohen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara" Subjekti "Sanitary Cleaning" shpk ka paraqitur fatura për pastrimin e spitalit Amerikan si dhe një tregu agro ushqimor, fatura këto që nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin në fjalë. Përsa më sipër jemi në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, pasi operatori ekonomik "Sanitary Cleaning" shpk nuk ka dokumenta që e provojë se ka realizuar shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, sic është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DST në tender. VII- Përsa i perket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 6. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatoam se ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik: "dokumenti-i pronësisë së ambientit të subjektit "Pastrimi Detar" sha ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë, shoqëruar me leje nga QKL, autorizim mjedisor për aktivitetin në lavanderi, shoqëruar me akt-teknik për sa i takon masave mbrojtëse ndaj zjarrit, por mungon" dokumenti Policë Sigurimi e Përgjegjësisë Profesionale për kontrata dhe eksperiencën të ngjashme me objektin e prokurimit. Ndërsa për subjektin "Sanitary Cleaning" shpk nuk ka të ngarkuar në sistem asnjë dokument për të vërtetuar se disponon ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit të lavanderisë. VIII- Përsa i perket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 7. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatoam se ndodhen të ngarkuara në sistemin elektronik të APP-se "dokumenti - i disponimit të makinerive të subjektit "Sanitary Cleaning" shpk jo për të gjitha makineritë. Ndërsa subjekti "Pastrimi Detar" sha nuk ka të ngarkuar në sistem asnjë dokument për të vërtetuar se disponon makineritë përkatëse në formën e kërkuar në DST dhe të pranuar nga operatori (keni paraqitur inventar në formën e vetëdeklarimit, por të pa konfirmuar nga asnjë institucion shtetëror). Në VKM nr. 914 datë 29.12.2014 neni 74, pika 3 përcaktohet shprehimisht se : "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarreshje ". Përsa më sipër jemi në kushtet e mos plotësimit të kërkesave të VKM nr. 914 date 29.12.2014, pasi operatori ekonomik "Pastrimi Detar" sha nuk ka paraqitur dokument që të provojë se disponon makineritë përkatëse në

formën e kërkuar ne DST, siç është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DST në tender, ndërsa subjekti "Sanitary Cleaning" shpk ka paraqitur dokumentacion jo për të gjitha makineritë IX- Përsa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 8. Pas verifikimit në sistemin elektronik të APP-së, konstatoam se ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik: dokumentacioni që subjekti "Pastrimi Detar" sha disponon mjet transporti i përshtatshëm për transportin e materia/eve të buta, ndërsa nuk ndodhet i ngarkuar në sistem dokumentacioni i subjektit "Sanitary Cleaning" shpk se disponon të paktën mjet transporti. Në V.K.M nr. 914 datë 29.12.2014 neni 74, pika 3 përcaktohet shprehimisht se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbush e kërkesat ligjore, të para shikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare , profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë , shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje ". X-Përsa i përket pretendimeve tuaja lidhur me pikën 9. Pas verifikimit ne sistemin elektronik te APP-se, konstatoam se ndodhet i ngarkuar në sistemin elektronik "Shtojca 5 dhe Specifikimet teknike të subjektit "Sanitary Cleaning" shpk e plotësuar vetëm në emër të subjektit dhe jo e bashkimit të operatoreve ekonomike", ndërsa per subjektin "Pastrimi Detar" sha nuk ka asnjë dokument të ngakuar që të provojë se ka plotësuar shtojcën 5 dhe konfirmuar specifikimet teknike [...]"

II.7. Në datën 11.03.2016 bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 27.04.2016, nëpërmjet shkresës me nr.735/1 prot., datë 26.04.2016, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Sanitary Cleaning" sh.p.k & "Pastrimi Detar" sh.a. mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se "[...]Nuk keni paraqitur prokurë të posacme si bashkim operatorësh ekonomikë [...]". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.2.Në shtojcën 7 "Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/pranimi", të dokumenteve të procedurës së prokurimit object ankimi parashikohet se:

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorëzohen:

a. *Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*

b. *Prokura e posaçme.*

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në procedurën e prokurimit objekt ankimi, operatorët ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe “Pastrimi Detar” sh.a. kanë dorëzuar ofertë në cilësinë e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, bashkim i krijuar me anë të kontratës nr.569 rep dhe nr.265 kol datë 19.03.2016 të lidhur para një noteri publik.

III.1.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se : “1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....**Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.* Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.” “3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*”

Në nenin 64, 70, 71,72 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikohet se

*Neni 64*

*Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (I përfaqësuar). Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.*

Neni 70

*Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.*

*vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.*

Neni 71

*Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht. Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.*

Neni 72

*Prokura bëhet gjithmonë me shkresë. Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë. Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial”*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes kanë dorëzuar në S.P.E. kontratën nr. 569 rep dhe nr.265 kol datë 19.03.2016 të lidhur para një noteri publik me anë të së cilës është krijuar bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k.& “Pastrimi Detar” sh.a. Në interpretimin sistematik (domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik) të nenit 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, *stricte sensu* parashikohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë pas krijimit të tyre me anë të marrëveshjes së noterizuar *aktgjatë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës*. Instituti i përfaqësimit rregullohet nga nenet 64 e vijues të Kodit Civil. Kuptimi i përfaqësimit në paragrafin e parë të dispozitës së mësipërme, përcaktohet : “ Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).”Referuar përfaqësimit me prokurë, Kodi Civil parashikon se prokura mund të jetë e posaçme ose e përgjithshme konform nenit 70 e vijues të Kodit Civil. Siç konstatohet nga rregullimi ligjor, që Kodi ynë Civil, i bën këtij instituti, veprimet e kryera nga përfaqësuesi, i sjellin pasojat juridike në emër e për llogari të të përfaqësuarit. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Prokura, si akt përfaqësimi, është një institut i ndryshëm dhe nuk mund të përfshihet nga regjimi normal i garancive që parashikon kontrata e bashkëpunimit e lidhur mes palëve. Vetë akti normative në zbatim të ligjit, neni 74 i Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit

*publik” të ndryshuar, ndan qartësisht momentin e hartimit të kontratës së bashkëpunimit mes palëve nga njëra anë dhe hartimin, dorëzimin e prokurës së posaçme për përfaqësimin në procedurën e prokurimit nga ana tjetër. Në interpretim të dipozitave ligjore të sipërcituara, K.P.P. gjykon se prokura e posaçme si një akt i veçantë juridik prej të cilës i përfaqësuari përcakton tagrat, natyrën e tyre, vëllimin, kohëzgjatjen është një akt i ndryshëm juridik dhe i veçantë nga kontrata e bashkëpunimit, si përsa i përket anës formale të hartimit të saj dhe bazës ligjore me anë të së cilës krijohet nga njëra anë, gjithashtu edhe me përmbajtjen substanciale të aktit. Mungesa e prokurës si akt i veçantë përfaqësimi parashikuar nga neni 70 e vijues i Kodit Civil, jo vetëm e bën ofertën ekonomike të pavlefshme por nuk legjitimon njëëherazi shoqërinë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. të dorëzojë ofertë ekonomike për llogari të një shoqërie tjetër , përsa kohë që kjo e fundit në asnjë rast nuk gëzon tagra përfaqësimi.*

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a. mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “[...]operatori ekonomik “Pastrimi Detar” sha nuk ka paraqitur Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore duke mos plotësuar Kriteret e Pergjithshme të Kualifikimit të kerkuara ne DST. [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Pergjithshme të Kualifikimit/pranimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet se:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në procedurën e prokurimit objekt ankimi, operatorët ekonomikë anëtarë I bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe “Pastrimi Detar” sh.a. , “Pastrimi Detar” sh.a. nuk ka dorëzuar Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

III.2.3. Në nenin 45 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “[...]2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t’i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të

njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “c”;

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh” [...]”

III.2.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 3 të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se : “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Në nenin 46, pika 1 gërma “ç” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. ç) kapacitetet ligjore:

*operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.”*

III.2.5. Në interpretim literal të nenit 74 pika 3 të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nga verifikimet e kryera në S.P.E. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pastrimi Detar” sh.a. nuk ka dorëzuar asnjë dokument në përputhje me kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pranimit si edhe në zbatim të nenit 45 të LPP. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë se “[...]Sa i përket mosparaqitjes së Deklaratës mbi Gjendjen Gjyqësore nga OE “Pastrimi Detar” sha, shprehemi se kjo kërkesë nga ana e AK është në tejkalim të përcaktimeve ligjore të përcaktuara nga neni 45 i LPP dhe neni 15 i RrPP.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentet standarde të tenderit janë miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik në zbatim të nenit 13 pika 2 gërma “ç” të LPP dhe se ofertat duhen hartuar dhe dorëzuar në zbatim të dokumenteve të procedurës/ave të prokurimit, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe aktit normativ në zbatim të ligjit. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pastrimi Detar” sh.a. nuk ka dorëzuar vetëdeklaratë “Shtojcën Extra” të gjendjes gjyqësore dhe nuk përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimeuse nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar.” Sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se “[...]Nuk keni paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë sipas kërkesave të kërkuara në DST, [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “d” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar: “d) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik i regjistruar në Shqipëri”

III.3.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “Sanitary Cleaning” sh.p.k. & “Pastrimi Detar” sh.a. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ( S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

i. Dokumenti me emërtim “Aktivi i Llogarisë”

- ii. *Kopje të sistemit të faturimit të lëshuar nga OSHEE Sh.a për abonentin “Pastrimi Detar” sh.a.*

III.3.3 Në Nenin 28 “Kontrata e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet që: [...]Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

III.3.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Në Nenin 48, pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “ [...] Paraqitja e ofertave bëhet si më poshtë: b) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore [...]”

III.3.5. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim ( OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijëni Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në



fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.
2. Konsumatori rezulton debitor.
3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.
4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.
5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]"

Gjithashtu referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim ( OSHEE Sh.a), në datën 30.03.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 6287/1 prot., me objekt: "Kthim përgjigje kërkesës për informacion", në të cilin dorëzohet një kopje e formatit standard të lëshimit të vërtetimit të debisë nga ku rezulton se është si më poshtë vijon:

"[...] Bazuar në deklarinimet e deklaruesit ( përfaqësuesit ligjor) z. \_\_\_\_\_ vërtetojmë se kërkuesi \_\_\_\_\_ nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratata (me kod) \_\_\_\_\_, titular i së cilës/cilavë është \_\_\_\_\_ rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e përllogaritur deri në datën \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_ pa përfshirë faturën koherente të muajit \_\_\_\_\_ [...]"

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se akti normativ në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se *strictu sensu* operatorët ekonomik për të dëshmuar se kanë shlyer të gjithë detyrimet e energjisë elektrike duhet të dorëzojnë në S.P.E. vërtetimin e lëshuar nga *Furnizuesi i energjisë elektrike* ( Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike –OSHEE). Pretendimet e palës ankimuese se "[...]Në lidhje me vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë, janë dorëzuar dy dokumente, përkatësisht Dokumenti i printuar dhe konfirmuar nga OSHEE i datës 15.06.2016, ku vërtetohet shlyerja e detyrimeve deri në muajin Janar (i përfshire), si dhe dokumenti i bankës i datës 20.03.2016, ku vërtetohet shlyerjen në datën 15.03.2016 të energjisë së maturuar të muajit Shkurt në vlerën 108 943.15 leke, vlerë e cila korespondon me vlerën e përcaktuar në dokumentin e parë.Sa i përket shoqërisë "Sanitary Cleaning" shpk, sqarojme se kjo kompani e ushtron aktivitetin e saj brenda ambjentëve të Spitalit Amerikan 1 dhe 2 Tirane, ne ambjentet e tregut Agro-Ushqimor Kashar Tirane, si dhe ne Godinen Bushi System Rogozhinë, dhe detyrimet e energjisë elektrike shlyhen sipas marrëveshjeve përkatëse, nga operatorët e mësipër privat, shërbimi i pastrimit të të cilëve ju

ofrohet. [...]” nuk mund të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik, pasi këto janë marrëdhënie që lindin mes konsumatorit (palës ankimuese në rastin konkret) dhe OSHEE Sh.a. Në nenin 28, pika 4 gërma “ç” të VKM 914/2014 ku parashikohet se: *“Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”* Akoma më tej, K.P.P. konstaton se referuar dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ky i fundit në asnjë rast nuk është në formatin standard të vërtetimit të miratuar nga OSHEE Sh.a. Gjithashtu K.P.P. gjykon se dokumentacioni i sipërcituar nuk mund të shërbejë si dokument për vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike në të gjithë vendet e ushtrimit të aktivitetit. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk kanë dorëzuar asnjë dokument provues për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, ndërkohë që referuar dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a. mbi skualifikimin e ofertës së tyre me argumentin se *“[...]Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë ISO 9001: 2008, Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2004, 6. operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001: 2004, [...]”*. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

#### Public Health Sector

III.4.1. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se operatori ekonomik ankimes është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tyre *inter allia* edhe me argumentin se : *“[...]Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë ISO 9001: 2008, Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2004, 6. operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001: 2004, [...]”*

III.4.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimes dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. & “Pastrimi Detar” sh.a. është njoftuar me anë të S.P.E. për skualifikimin e ofertës së tij për mos përmbushje të kritereve të veçanta të kualifikimit, konkretisht *“1 Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të kualitetit të shoqërisë ISO 9001: 2008, Nuk keni paraqitur certifikate që vërteton sistemin e kontrollit të Biokontaminimit UNI ENI 14065:2004, 6. operatori ekonomik “Sanitary Cleaning” shpk nuk ka paraqitur certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001: 2004,”*. Nga

shqyrtimi i ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka ngritur pretendime, kundërshtime, për arsyet e mësipërme të skualifikimit.

III.4.2. Neni 63, pika 1, e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull *“Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në nenin 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar parashikohet se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me arsyet e parë të skualifikimit, do të pranohet nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi, për arsyet e tjera të skualifikimit nuk janë ngritur pretendime si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë KPP, çka sjell se gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-së janë afate prekluzive. Këto afate, duke qenë afate prekluzive (dekadence), nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Sa më sipër, e drejta e ankimit për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre ekonomike për shkak se nuk është ezauruar pranë autoritetit kontraktor ka rënë në dekadencë. Akoma më tej, konstatohet se referuar edhe ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues të ezauruar pranë K.P.P. në asnjë rast nuk janë ngritur pretendime për arsyet e mësipërme të skualifikimit.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a. mbi skualifikimin e ofertës së tyre në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe bashkimi operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tyre faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores*

“Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Sanitary Cleaning” sh.p.k & “Pastrimi Detar” sh.a. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-25332-02-23-2016 me objekt “Shërbimi i Lavenderisë dhe Hotelerisë” me fond limit 94,813,099.16 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 21.03.2016 nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli, Elbasan
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**Nr. 962 Protokoli; Datë 20.04.2016;**

